



REPUBLIKA E KOSOVË
Drejtoria e Inspeksionit
Gllgoc, me 28.12.2017



RAPORT PËR MUAJIN DHJETOR 2017

Gjatë këtij muaji me rëndësi të veçant kemi vazhduar me inspektimin e subjekteve afariste për kontrollë të Ligjit të duhanit, duke mbajtur edhe punë kujdestarie me qëllim të vetëdijësimit të qytetarëve në zbatim të këtij Ligji. Gjithashtu kontrollë e rendit të udhëtimit të Kompanive transportuese të udhëtarëve dhe transportin ilegal. Në vazhdim po ju sjell punët e kryera nga secili Inspektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

Inspektori Sanitar ka inspektuar subjektet afarsite hoteliere për kontrollë të Ligjit të duhanit gjatë kujdestarisë në orët e mbrëmjes me qëllim që shqiptuar 17 gjoba për shkelësit e Ligjit. Gjithashtu gjatë këtij muaji ka inspektuar të gjitha qendrat e mjekësisë familjare dhe ka hartuar raport të veçant për to.

Inspektori i Ndërtimit ka vazhduar me kontrollë të ndërtimeve pa leje dhe gjatë këtij muaji është bërë rrënim i dy objekteve, përmes Kompanisë së rrënit "ASS" sh.p.k. Inspektori i Ndërtimit gjatë këtij muaji ka bërë mbikqyerje të punimeve (në cilësinë e Organit mbikqyrës):

- në projektin për rregullimin e rrethojave të shkolles në fshatin Baicë, Abri dhe Gllanasellë.

- Gjithashtu ka qenë pjesë e Komisionit për vlerësim të dëmeve nga fatkeqësit natyrore.

Inspektori i Tregut ka inspektuar në veqanti bastoret sportive rreth dokumentacionit të tyre, ndërkaq gjatë këtij muaji ka mbyllur tri nga ato të cilat e zhvillojnë veprimtarinë pa dokumente të duhura.

Inspektori Financiar ka vazhduar me inspektim të bizneseve rreth kryerjes së obligimeve të takses komunale.

Inspektori i Ambientit ka kryer inspektime në shqyrtim të kërkesave të qytetarëve si dhe urdhëresë për ato subjekte të cilat nuk janë kyqur në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

Inspektori i Komunikacionit ka kryer kontrolla të rendit të udhëtimit të Kompanive Transportuese të udhëtarëve dhe Transportuesit ilegal, si dhe ka vazhduar me masën e radhes duke bërë konfiskimin e automjeteve dhe targave të transportuesve ilegal.

Në vazhdim po paraqesim një pasqyrë të punës në shifra për muajin dhjetor 2017:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktvendime	Gjaba mandat.	Fletëparaqitje	Kërkesa	Pëlqim për biznes	Shqyrtim i Kërkesave	Rrënim i objekteve	Mbyllje biznesi	Konfiskim targave dhe automjeteve
I.Sanitare	39		17							
I.Tregut	14	3							3	
I.Financiare	27									
I.komunikacionit	15			6	6		6			1+4
I.Ndërtimit	16	4	2		4		4	2		
I.Ambientit	7									
Gjithsej	118	7	19	6	10	0	10	2	3	5

Dhjetor 2017

Shef i Inspekcionit: ARIANA SADIKU